



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 113/3 Prot

Tiranë, më 11.02.2019

V E N D I M

Nr.7, datë 11.02.2019

***“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj
nëpunësit *****”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 113 prot., datë 30.01.2018, kërkuesi ***** ka ngritur pretendimin se, procedimi disiplinor i filluar ndaj tij është zhvilluar në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në vendimin nr. 115, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezultoi se, punonjësi *****, është nëpunës civil, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektiveve”, emëruar me aktin nr. 6088/2 prot., datë 08.11.2017, të Departamentit të Administratës Publike.

Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, e ka fillimin në momentin kur Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me memon nr. 9053 prot., datë 11.12.2018, ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm (titullarin) të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për mosparaqitjen

në punë të nëpunësit ***** prej datës 10.10.2018 e në vazhdim. Pas vlerësimit paraprak të këtyre pretendimeve për shkelje disiplinore, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, në cilësinë e eprorit direkt, me vendimin nr. 9053/1 prot., datë 12.12.2018, ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit në fjalë.

Në përmbajtje të kësaj shkrese rezulton se, ecuria disiplinore ndaj këtij nëpunësi është kërkuar për shkak të braktisjes së punës për më shumë se 7 ditë punë, duke filluar nga data 09.10.2018-12.12.2018, mospërmbushjes së rendë të detyrave si dhe mosrespektimit të përsëritur të afateve në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda.

Shkeljet e mësipërme, në kuptim të nenit 57, pika 2, germa “a”, “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, klasifikohen si shkelje shumë të rënda disiplinore dhe për këtë arsye titullari i institucionit ka vendosur kalimin e akteve dhe procedimit disiplinor për shqyrtim, Komisionit Disiplinor. Në këto kushte, me urdhrin nr. 9053/2 prot., datë 19.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, është ngritur Komisioni Disiplinor, me përbërje si më poshtë:

- ***** , Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse – Kryetar, në cilësinë nëpunësit civil më të lartë në institucion;
- ***** , Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit – anëtar, në cilësinë e eprorit direkt;
- ***** , Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve – anëtar, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë së burimeve njerëzore;
- ***** , Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut – anëtar në cilësinë e nëpunësit më të vjetër civil në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit;
- ***** , – anëtar, në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë përgjegjëse, Departamentit të Adminsitratës Publike (*caktuar me autorizimin nr. 9015 prot., datë 26.12.2018*).

Komisioni Disiplinor, me marrjen dijani për faktet e mësipërme, me aktin nr. 9053/3 prot., datë 19.12.2018, ka njoftuar nëpunësin, të cilit i atribuohet shkelja, duke i garantuar të drejtat që parashikohen në pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të tilla si e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor.

Rezulton se, seancat dëgjimore të caktuara për t’u zhvilluar në datat 26.12.2018 dhe 11.01.2019, nuk janë zhvilluar, për shkak të mos marrjes dijani prej nëpunësit për zhvillimin e procedimit disiplinor, fakt që materializohet në procesverbalet respektive nr.

9053/4-1 prot., datë 26.12.2018 dhe nr. 9053/7 prot., datë 11.01.2019, të mbajtura nga Sekretariati Teknik i ngritur për të asistuar Komisionin Disiplinor.

Në vijim të këtij veprimi administrativ, rezulton se Komisioni Disiplinor, me aktin nr. 9053/8 prot., datë 11.01.2019, ka njoftuar nëpunësin ***** për caktimin e seancës dëgjimore të radhës në datën 18.01.2019, për të cilën rezulton të mos ketë asnjë akt administrativ, që të materializojë zhvillimin e kësaj seance.

Më tej, rezulton se, me urdhrin nr. 9053/9 prot., datë 25.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, është ndryshuar përbërja e Komisionit Disiplinor, duke u vendosur zëvendësimi i anëtarit *****, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme me anëtarin *****, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut.

Seanca disiplinore për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara ndaj ankuesit është zhvilluar në datën 01.02.2019, pasi rezulton se seanca e caktuar në datën 25.01.2019, është shtyrë për shkak të konstatimit të mos paraqitjes së anëtares *****, për arsye shëndetësore si dhe të nëpunësit civil në procedim. Në lidhje me mungesën e nëpunësit *****, Komisioni Disiplinor pretendon që ky nëpunës të ketë marrë dijeni për zhvillimin e kësaj seance dhe të mos ketë paraqitur shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij.

Nga përmbajtja e procesverbalit nr. 9053/14, datë 01.02.2019, rezulton se edhe në këtë seancë, Komisioni Disiplinor ka konstatuar mungesën e anëtares ***** (për arsye shëndetësore) si dhe mungesën e pajustificuar të nëpunësit *****. Në këto kushte, Komisioni Disiplinor, duke iu referuar pikës 2 dhe 4, të Kreut C, “Seanca e shqyrtimit të çështjes në procedim”, të udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesore procedurialë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, ka vendosur zhvillimin e mbledhjes së komisionit si dhe vazhdimin e ecurisë disiplinore në mungesë të nëpunësit *****.

Në përfundim të shqyrtimit të shkeljes disiplinore të pretenduar, Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 9053/15 prot., datë 01.02.2019, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësin *****. Më tej, me urdhrin nr. 9053/16 prot., datë 04.02.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, është vendosur ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për nëpunësin në fjalë.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit Disiplinor, argumentohet se, dhënia e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” është rrjedhojë e shkeljeve shumë të rënda disiplinore të kryera nga nëpunësi *****, me pretendimin se ky nëpunës ka braktisur punën dhe ka munguar në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për më tepër se 7 ditë pune, sjellje e cila ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit.

Nga përmbajtjen e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe tërësisë së dokumentacionit që materializon këtë procedurë, rezulton se, nëpunësi *****, ka depozituar në zyrën e protokollit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, dokumentacionin si më poshtë:

- a- Epikrizë sëmundje, lëshuar nga mjekja Lozana Binjaku, pranë Spitalit Universitar i Traumës më datë 11.12.2018, nëpërmjet të cilës vërtetohet mungesa e justifikuar për periudhën 10.10.2018-11.12.2018;
- b- Raporti për paaftësi të përkohshme në punë, për periudhën 26.12.2018-29.12.2018, lëshuar nga Urgjenca Mjekësore;
- c- Vërtetim nr. 39471 rregj, datë 24.12.2018, i Spitalit Universitar të Traumës, nëpërmjet të cilës rekomandohet 2 (dy) javë pushim, prej datës 12.12.2018-28.12.2018.

Këto dokumente, rezultojnë të mos jenë pranuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Financës, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, me arsyen se, këto dokumente nuk justifikojnë mungesën, pasi nuk disponojnë raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku dhe si rrjedhim ky nëpunës nuk mund të trajtohet me pagesë, për periudhën 10.10.2018-28.12.2018. Në kuadër të hetimit administrativ, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, me shkresën nr. 451 prot., datë 21.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka kërkuar informacion nga Spitali Universitar i Traumës, në lidhje me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e akteve të mësipërme mjekësore.

Në përgjigje të sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 217/1 prot., datë 24.01.2019, Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës "*Kthim përgjigje*", sqaron që nëpunësi *****, është paraqitur në urgjencën e SUT, më datë 12.12.2018, në orën 10:14, me nr. 39471 rregjistri dhe pasi kanë konstatuar diagnozën i është rekomanduar 2 (dy) javë pushim (*për të cilat nëpunësi disponon dhe raportin mjekësor*). Nga ana tjetër, në përmbajtje të kësaj shkrese, deklarohet se, për shtetasin në fjalë, nuk disponohet dokumentacion tjetër zyrtar (*dokumentacion shkresor*) të jetë lëshuar nga SUT, apo mjekja *****.

Faktin e mësipërm, Komisioni i Disiplinës e ka marrë të mirëqenë dhe pa kryer verifikime apo hetim të mëtejshëm administrativ, ka arritur në përfundimin se jemi para një shkelje shumë të rëndë disiplinore duke aplikuar masën e largimit nga shërbimi civil.

Në lidhje me këtë qëndrim të Komisionit Disiplinor, nëpunësi *****, në kërkesën e paraqitur prej tij ka ngritur pretendimin se, kjo paligjshmëri ka ardhur për shkak të shkeljeve të lejuara nga Komisioni Disiplinor në zbatimin e procedurës së përcaktuar në ligj për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, të cilat kanë ndikuar në arritjen e konkluzioneve të sakta dhe marrjen e një vendimi të drejtë.

Nisur nga sa më sipër, në vlerësim të rrethanave si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

vlerëson se në veprimet administrative të kryera prej Komisionit Disiplinor, në kuadër të shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara në ngarkim të nëpunësit ***** , janë lejuar/kryer shkelje të elementëve proceduralë, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor” dhe të të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, të cilat analizohen si më poshtë.

Në rastin konkret, rezulton se shkeljet disiplinore të konstatuara në vendimin nr. 9053/1 prot., datë 12.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, në ngarkim të nëpunësit ***** , janë klasifikuar si shkelje shumë të rëna disiplinore. Në këto kushte, në zbatim të nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, organi disiplinor për shqyrtimin e shkeljeve të kësaj natyre është Komisioni Disiplinor. Ky organ administrativ ndërtohet dhe funksionon në bazë të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i cili përcakton në mënyrë të detajuar përbërjen e Komisionit Disiplinor si dhe procedurën konkrete që duhet të zbatohet për shqyrtimin e shkeljes nga ana e tij.

Konkretisht në Kreun I, pika 2, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, Komisioni Disiplinor për institucionet e administratës shtetërore përbëhet nga 5 anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

- a) ***nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilën ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;***
- b) *eprorin direkt të nëpunësit civil, për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- c) *drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- d) *një përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike;*
- e) *nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.*

Nisur nga sa më sipër, dhe në referencë të dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në rastin konkret, përbërja e Komisionit Disiplinor (*ngritur me urdhrin nr. 9053/2 prot., datë 19.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU*), është e parregullt, pasi rezulton se, kryetari i këtij komisioni ***** , me detyrë “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme*”, i cili është emëruar dhe ka marrë pjesë në shqyrtimin e ecurisë disiplinore, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nuk përmbush kushtet e parashikuara në dispozitën e sipërcituar, duke sjellë në këtë mënyrë një gjendje paligjshmërie në funksionimin e Komisionit.

Vlerësohet se kjo paligjshmëri ka ardhur si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit jo të drejtë të legjislacionit të posaçëm për shërbimin civil, në lidhje me përcaktimin e nëpunësit më të lartë civil të institucionit, i cili duhet të drejtojë Komisionin Disiplinor.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në kuadër të trajtimit të rastit konkret, konstaton faktin se, institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ushtron kompetencat dhe funksionet e tij mbi bazën e ligjit nr. 9863, datë 28.01.2003, “Për ushqimin”, i ndryshuar, ku në nenin 61 të tij, përcaktohet se, ky institucion është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (*ish Ministria e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*). Nisur nga kjo, në kuptim të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe të klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm përbën nëpunësin më të lartë civil.

Nisur nga veçoria e rastit konkret, për shkak të mënyrës së klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil si dhe në analizë të strukturës organizative të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe të linjës hierarkike, konstatohet se në rastin e nëpunësit *****, i cili mbante pozicionin “Drejtor Drejtorie”, me cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit paraqitet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kushtet kur pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, nuk është përfshirë në shërbimin civil.

Komisioneri vlerëson, se kjo parregullsi në përbërjen e Komisionit Disiplinor, nuk është rregulluar as me aktin nr. 9053/9 prot., datë 25.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, “Për një ndryshim në përbërjen e Komisionit”, pasi konstatohet se nëpunësi ***** (në cilësinë e Kryetarit) është zëvendësuar me punonjësin *****, i cili është nëpunës i nivelit të mesëm drejtues, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut.

Duke trajtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve administrative të Komisionit Disiplinor, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton elementë të paligjshmërisë në drejtim të garantimit të së drejtës së nëpunësit për tu njoftuar dhe marrë djepi për fillimin e procedimit disiplinor, ecurisë se këtij procesi dhe përfundimit të tij.

Konkretisht, në procesverbalet nr. 9053/4-1 prot., datë 26.12.2018 dhe nr. 9053/7 prot., datë 11.01.2019, rezulton se, njoftimi i këtij nëpunësi është bërë nëpërmjet dërgimit me postë të aktit të njoftimit, i cili ka rezultuar i pasukseshëm, për shkak të adresës jo të saktë të banimit të nëpunësit *****.

Në seancën dëgjimore të datës 11.01.2019, Komisioni Disiplinor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur njoftimin e këtij nëpunësi nëpërmjet mesazheve telefonike dhe telefonatave, por

nuk rezulton që në praktikën e kësaj procedurë të ndodhen akte të cilat materializojnë njoftimin nëpërmjet kësaj forme.

Më tej, rezulton e provuar se nëpunësi ***** ka marrë dijëni për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij vetëm në datën 21.01.2018, me paraqitjen e tij pranë zyrës së protokollit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Ky fakt vërtetohet jo vetëm me nënshkrimin e këtij punonjësi në rregjistrin e protokollit, si dhe në procesverbalin nr. 9053/14 prot., datë 01.02.2019, në përmbajtje të se cilës Komisioni deklaroi se ky nëpunës ka marrë dijëni për fillimin e ecurisë disiplinore, duke pohuar njëkohësisht se nëpunësi nuk është njoftuar për datën e seancës së ardhshme disiplinore.

Në vijim të kësaj analize, evidentohet fakti se, në procesverbalin nr. 9053/11 prot., datë 30.01.2019, Komisioni Disiplinor, ka konstatuar mungesën e nëpunësit ***** duke pretenduar se ai ka marrë rregullisht njoftim për këtë seancë, por duke mos evidentuar formën e njoftimit dhe duke mos administruar aktet që materializojnë marrjen dijëni për caktimin e datës së zhvillimit seancës dëgjimore.

Njëkohësisht, nga përmbajtja e procesverbalit nr. 9053/14, datë 01.02.2018, Komisioni Disiplinor pretendon se, nëpunësi ka marrë dijëni për zhvillimin e kësaj seance. Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri administroi dhe analizoi procesverbalin nr. 9053/11 prot., datë 30.01.2019, të mbajtur në zyrën e protokollit, në prani të ***** Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, ***** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve dhe punonjëses së protokollit *****.

Në përmbajtje të këtij procesverbali raportohet se, nëpunësi ***** pasqishtë njohur me përmbajtjen e shkresës nr. 9053/12 prot., datë 30.01.2019, të Komisionit Disiplinor “Njoftim për seancën e ardhshme dëgjimore datë 01.02.2019”, ka refuzuar marrjen në dorëzim të saj si dhe nënshkrimin e tij në librin e dorëzimit të faktit të refuzimit.

Duke analizuar përmbajtjen e procesverbalit të refuzimit të marrjes në dorëzim, konstatohet se, ai nuk është mbajtur në përputhje me kërkesat e nenit 159, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pasqis edhe pse rezultoi që ky procesverbal të jetë mbajtur në prezencë të punonjësve ***** dhe ***** nuk konfirmohet që këto të fundit të kenë qënë dëshmitarë të pranishëm në momentin e kryerjes së këtij veprimi, fakt që cënon vërtetësinë e këtij procesverbali.

Njëkohësisht, në procesverbalin nr. 9053/14 prot., datë 01.02.2019, të Komisionit Disiplinor deklarohet se nëpunësi ***** është njoftuar rregullisht dhe ka marrë dijëni për zhvillimin e seancës së datës 30.01.2019 dhe 01.02.2019, nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail), duke argumentuar se konfirmimi i marrjes dijëni bëhet nëpërmjet një sistemi automatik, i cili paraqet datën dhe orën e marrjes dhe leximit të emailit. Megjithatë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, rezultoi e provuar, se nëpunësi ka marrë dijëni nëpërmjet komunikimit elektronik vetëm

për seancën dëgjimore të caktuar në datën 01.02.2019. dhe jo për seancat e mëparshme dëgjimore.

Për më tepër, në pjesën arsyetuese të vendimit për marrjen e masës disiplinore, pretendohet se, Komisioni Disiplinor në seancën e datës 18.01.2019 ka vendosur të njoftojë këtë nëpunës nëpërmjet shpalljes publike. Në lidhje me këtë fakt, Komisioneri konstaton se, në praktikën shkresore të këtij procedimi disiplinor, nuk evidentohet asnjë akt administrativ që të materializojë zhvillimin e kësaj seance si dhe vendimmarrjen e këtij komisioni për mënyrën e njoftimit të nëpunësit në procedim. Në kushtet kur, nuk ka nje vendimmarrje të komisionit për njoftimin e këtij nëpunësi nëpërmjet njoftimit publik, në zbatim të nenit 162, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, vlerësohet se ky njoftim nuk është kryer dhe për rrjedhojë nëpunësi nuk ka marrë dijeni.

Detyrimi ligjor për t’u njoftuar për fillimin e një veprimi administrativ, në rastin konkret procedimit disiplinor, përcaktohet shprehimisht në nenin 59, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se, procedimi administrativ ndër të tjera duhet të garantojë të drejtën e nëpunësit civil, për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, me qëllim garantimin e të drejtës së nëpunësit për të paraqitur prova dhe për t’u dëgjuar në lidhje me shkeljet faktike të pretenduara.

Nga sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, krijohet bindja se Komisioni Disiplinor, nuk ka garantuar të drejtën e nëpunësit për njoftimin e ecurisë disiplinore, pasi nuk provohet që nëpunësi ***** të ketë marrë dijeni rregullisht në lidhje me caktimin e seancave disiplinore.

Vlerësohet se, Komisioni Disiplinor, nëpërmjet veprimeve të kryera prej tij, muk ka siguruar zhvillim normal të procedurës për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara në ngarkim të nëpunësit në fjalë.

Me qëllim kryerjen e një procedurë të rregullt ligjore, në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për elementët kryesore procedurale dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, përcaktohen në mënyrë eksplicite roli, funksionet dhe kompetencat e secilit prej anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Në kapitullin B, “*Detyrat dhe funksionet e antërarëve të KD*”, të këtij udhëzimi, përcaktohet se, anëtari i KD, në cilësinë e drejtuesit të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, mban përgjegjësi për funksionimin e Sekretariatit Teknik të KD dhe siguron evidentimin dhe faktimin e të gjitha veprimeve të kryera nga ky komision, në kuadër të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Konkretisht, ky person, ndër të tjera është përgjegjës për përgatitjen e njoftimeve për mbledhje si dhe për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Referuar praktikës që materializon procedurën disiplinore në ngarkim të nëpunësit ******, konstatohet se, me aktin nr. 9053/8 prot., datë 11.01.2019, është njoftuar se seanca e ardhshme dëgjimore do të zhvillohet në datën 18.01.2009, por nuk rezulton që kjo seancë të jetë zhvilluar, pasi nga ana e sekretariatit teknik nuk është mbajtur asnjë procesverbal i cili të dokumentojë zhvillimin e saj, prezencën e anëtarë të komisionit, çështjet që janë diskutuar dhe si vendimmarrjen e këtij komisioni për vijueshmërinë e procedimit disiplinor.

Nisur nga sa më sipër, në mungesë të akteve të nevojshme që materializojnë veprimet e komisionit disiplinor, arrihet në konkluzionin se, në rastin konkret janë lejuar shkelje të elementëve proceduralë, duke cënuar jo vetëm ligjshmërinë e këtij procesi, por dhe të drejtat legjitime të nëpunësit ****** për t'u informuar dhe njoftuar lidhur me ecurinë e procedimit disiplinor.

Në vijim të analizës së ligjshmërisë së procedimit disiplinor, objekt shqyrtimi, Komisioneri konstaton se, Komisioni Disiplinor ka vepruar në kapërcim të kompetencave të tij, të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke marrë në shqyrtim shkelje disiplinore të cilat, pretendohen të jenë kryer nga nëpunësi, pas fillimit të procedimit disiplinor.

Konkretisht, referuar praktikës shkresore të këtij procedimi disiplinor, konstatohet se, shkak i fillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ******, kanë qenë mungesat e kryera në punë prej tij për periudhën 10.01.2018-12.12.2018. Rezulton se, Komisioni Disiplinor, pasi ka konstatuar se nëpunësi në fjalë ka munguar në punë dhe për periudhën 12.12.2018 -21.02.2019, ka vendosur të shprehet për ligjshmërinë e këtyre mungesave, duke administruar provat shkresore, fakt që materializohet në procesverbalin nr. 9053/14 prot., datë 01.02.2019.

Duke vepruar sa më sipër, arrihet në konkluzionin se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi ky komision nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për shtim të objektit të procedimit disiplinor dhe për marrjen në shqyrtim të dokumenteve shkresore, që vërtetojnë kryerjen e mungesave nga nëpunësi ******. Në të njëjtën kohë, nuk rezulton që ky organ, të këtë njoftuar nëpunësin në lidhje me këtë veprim administrativ, duke cënuar kështu në mënyrë flagrante të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar në lidhje me shkeljet faktike, që pretendohen në ngarkim të tij.

Konstatohet se, ky veprim i Komisionit Disiplinor është kontestuar nga përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili në seancën dëgjimore të datës 01.02.2019, ka propozuar ndaj anëtarëve të tjerë të komisionit, të marrin vendim për shtim objekti, për shqyrtimin edhe të mungesave për periudhën 12.12.2018-21.02.2019. Kjo kërkesë, rezulton të jetë refuzuar nga anëtari ******, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AKU, me

pretendimin se kjo kërkesë duhet të ishte parashtruar që në seancën e parë dhe jo në këtë fazë të shqyrtimit.

Në vijim të analizës së ligjshmërisë së procedimit disiplinor në ngarkim të nëpunësit ******, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se vendimmarrja e Komisionit Disiplinor është rrjedhojë e mos kryerjes së një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative

Konkretisht, referuar dokumentacionit të administruar, konstatohet se prej nëpunësit ******, me qëllim justifikimin e mungesave të kryera prej tij në datat 10.10.2018 - 12.12.2018, janë depozituar pranë zyrës së protokollit të AKU aktet mjekësore, të lëshuara nga autoritetet përkatëse. Rezulton se këto akte, nuk janë pranuar, me arsyetimin se, ato nuk shoqërohen me raporte mjekësore dhe për rrjedhim nga njësia e financës së këtij institucioni nuk ka vijuar me pagesën për paaftësi shëndetësore.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni Disiplinor, i është drejtuar Spitalit Universitar të Traumës, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë dhe vërtetësisë së akteve mjekësore të sjella prej nëpunësit të proceduar. Në aktin nr. 217/1 prot., datë 24.01.2019, të Drejtorit të Spitalit Universitar i Traumës “*Kthim përgjigje*”, është konfirmuar se, nëpunësi ****** është paraqitur pranë urgjencës së këtij institucioni në datën 12.12.2018 dhe i është rekomanduar 2 javë pushim, fakt që materializohet në vërtetimin nr. 39471 rregjistri, nr. 24.12.2018. Por nga ana tjetër, në përmbajtje të kësaj shkresë, institucioni SUT, deklaron se, nuk disponon asnjë dokument tjetër mjekësor të lëshuar nga ky institucion në lidhje me nëpunësin në fjalë.

Duke analizuar tërësinë e akteve të ecurisë disiplinore, Komisioneri, vlerëson se nga ana e Komisionit Disiplinor nuk është kryer një analizë tërësore dhe objektive e provave dhe fakteve të administruara në dosjen disiplinore. Kjo për faktin se, Komisioni Disiplinor, nëpërmjet memos nr. 9053 prot., datë 11.12.2019, të Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, ka ardhur në dijeni të faktit se, prej nëpunësit ****** janë dërguar nëpërmjet komunikimit telefonik foto të raporteve mjekësore për datat 09.10.2018 – 28.10.2018 (*akte të cilat rezultojnë të mos i jenë bashkëngjitur kësaj memoje*). Rezulton se, ekzistenca e këtyre raporteve mjekësore përmendet dhe në shkresate tjera, pjesë përbërëse e procedimit disiplinor.

Në pikën 14, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, përcaktohet se, organi disiplinor heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe të mund të përdorë çdo mjet për sigurimin dhe mbledhjen e provave të nevojshme për hetimin administrativ.

Referuar dispozitës së mësipërme ligjore dhe në kushtet kur, Komisioni Disiplinor kishte indicie për ekzistencën e akteve të tjera mjekësore, Komisioneri vlerëson se, ky i fundit duhet të kishte vijuar më tej, duke iu drejtuar organeve kompetente në marrjen e informacionit të nevojshëm, për më tepër kur rezulton se, Spitali Universitar i Traumës nuk ka kontestuar ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e akteve mjekësore, konkretisht epikrizës së vënë në dispozicion nga nëpunësi i proceduar.

Për më tepër, rezulton se, në procesverbalin nr. 9053/14 prot., datë 01.02.2019, konstatohet se të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili në seancën e datës 01.02.2019, caktuar për shqyrtimin e shkeljes disiplinore ndaj nëpunësit ******, ka refuzuar vendimmarrjen deri në një moment të dytë, duke kërkuar një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, mbi vlefshmërinë e raporteve dhe epikrizës, kërkesë e cila rezulton të mos jetë marrë në konsideratë apo të jetë hedhur në votim.

Në këto kushte, në referencë të dokumentacionit të sipërcituar, arrihet në konkluzionin se, vendimmarrja e këtij komisioni nuk është si rezultat i hetimit të plotë administrativ, por me veprimet e lejuara prej tij, krijohet bindja e një vendimmarrjeje dhe të një procesi të kryer me ngut, duke mos respektuar etapat e përcaktuara në legjislationin e fushës.

Si përfundim, për të gjitha arsyet që janë analizuar sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, vendimi nr. 9053/15 prot., datë 01.02.2019, i Komisionit Disiplinor, “*Për dhënien e masës disiplinore Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësin ******, është një akt i cili në kuptim të nenit 109, pika b, dhe d, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, përbën një akt të paligjshëm dhe për këtë arsye në referencë të nenit 114, pika 1, të po këtij ligji, ky akt duhet të shfuqizohet.

Po ashtu duhet të shfuqizohet akti nr. 9053/2 prot., datë 19.12.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, për ngritjen e Komisionit Disiplinor, si dhe akti nr. 9053/9 prot., datë 25.01.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, “*Për një ndryshim në përbërjen e Komisionit Disiplinor*”, që kanë si objekt shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar ndaj nëpunësit ******.

Për rrjedhojë, për shkak se vendimi është marrë nga një organ me përbërje jo të rregullt, duhet të shfuqizohet vendimi i Komisionit të Disiplinës nr. 9053/15 prot., datë 01.02.2019.

Më tej, në vijim të këtij arsyetimi, me shfuqizimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, si një akt i paligjshëm, titullari i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit duhet të shfuqizojë urdhrin nr. 9053/16 prot., datë 04.02.2019, ndërsa njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të marrë masa për rikthimin e këtij nëpunësi në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektiveve*”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në zbatim të nenit 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, duhet të shfuqizojë urdhrin nr. 9053/9 prot., datë 25.01.2019 për ngritjen e Komisionit të Disiplinës për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ***** dhe më pas të shfuqizojë urdhrin nr. 9053/2 prot., datë 19.12.2018, në pjesën ku “*****, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme”, caktohet Kryetar i Komisionit Disiplinor, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duhet të marrë masa për ringritjen e Komisionit Disiplinor, në përputhje me kërkesat e Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” dhe të respektimit të procedurës së zëvendësimit të anëtarëve të KD, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, duke respektuar elementët hierarkikë që kërkohen prej akteve të mësipërme, për të siguruar raportin e niveleve administrative, ndërmjet nëpunësit të proceduar dhe proceduesit.
3. Njësia e Burimeve Njerëzore të marrë masat për shfuqizimin e vendimit nr.9053/15 prot., datë 01.02.2019, të Komisionit Disiplinor, “Për dhënien e masës disiplinore Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësin *****, si një akt i nxjerrë në shkelje të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe nenit 109, pika “b” dhe “d”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të RSH”.
4. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duhet të shfuqizojë urdhrin nr. 9053/16 prot., datë 04.02.2019, me të cilin është vendosur ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për nëpunësin *****.

5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të marrë masa për rikthimin e këtij nëpunësi në pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektiveve”*.
6. Komisioni Disiplinor, në shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara ndaj nëpunësit ******, duhet të tregojë kujdes në respektimin dhe garantimin e të drejtave të nëpunësit civil, në një ecuri disiplinore dhe të kryejë një hetim administrativ të plotë e objektiv, për sqarimin e gjithë pretendimeve të ngritura.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
8. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
10. Të njoftohet për këtë vendim Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi ******.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha